




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI - OPSTINA VUCITRN



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
VU644 – 18 – 4785 – 1-3-6/C81
14 Nr. 651/18
Dt. 07.08.2018

KONTRATË FURNIZIMI

Palët kontraktuese :

1. Komuna e Vushtrrisë, si autoritet kontraktues, të cilën e përfaqëson : **Saranda Cakaj – Drejtoreshë për Prokurim Publik** (në tekstin e mëtejme **PORORSITËSI**), dhe
2. **NTSH “ Albkos Int “** me seli në **Fushë Kosovë**, me **NRB : 70575337** dhe **Nr. Fiskal : 600033170**, si Operatorë Ekonomik, të cilët i përfaqëson : **Emin Mirena**, në tekstin e mëtejme **SHITËSI - FURNITORI**

, janë pajtuar të lidhin këtë kontratë publike për furnizime dhe/ ose shërbime, si vijon:

Furnizimi me pajisje për Njësinë e Zjarrfikësve , me numër identifikues:

Prokurimi Nr.	VU644	1	8	47	8	5	1	3	6
Prokurimi Nr.	644	1	8	1	0	6	1	3	6

Neni 1 Lënda

- 1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i furnizimeve nga ana e Kontraktuesit, si vijon : **Furnizimi me pajisje për Njësinë e Zjarrfikësve**, sipas dokumentacionit standard dhe Specifikimit Teknik të ofertës me nr. Referues : **644-18-106-136**.

Neni 2 Kushtet e dërgesës

- 2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë: **30 ditë kalendarike nga data e nesërme pas nënshkrimit të kontratës**.
- 2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë **Njësia e Zjarrfikësve në Vushtrri**. Inspektimi i cilësisë dhe sasisë së mallit do të bëhet nga Komisionit të Pranimi të Mallit – Pajisjeve, i emëruar nga ana e Zyrtarit Kryesor Administrativ të Autoritetit Kontraktues. Asnjë furnizim i mallit respektivisht asnjë ekzekutim i shërbimeve nuk do të konsiderohet valid dhe i pranuar, deri sa nuk konfirmohet cilësia dhe sasia, nga ana e Komisionit të Pranimi të Mallit, të Autoritetit Kontraktues.
- 2.3 Furnizuesi merr për obligim dhe pajtohet që pajisjet ti dërgoi – transportoi, me shpenzime dhe mjete transporti të tija, deri te përfutuesi.

- 2.4 Në rast se Shitësi dështon në përmbushjen e detyrimeve të furnizimeve me artikuj të përcaktuar si në specifikimin teknik të dosjes së tenderit të cekur si në nenin një të kësaj kontrate, atëherë Blerësi mbanë të drejtën që për secilën ditë në vonesë, ndaj Shitësit, Blerësi, do të zbatohet penale me 0,25% të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara, deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.
- 2.3 Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP¹ (Dërgesat e Detyrës të Paguara).
- 2.4 Garancioni për cilësinë e paisjeve do të jetë përgjegjësi e Furnizuesit. Afati i garancionit fillon nga data e pranimit – dorëzimit të **pajisjeve dhe përfundon në një afat prej minimum 12 muajve.**

Neni 3 Çmimi

- 3.1 Çmimi total i furnizimeve duhet të jetë: **4.000,00€(katërmij/00€).**
- 3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër është i prerë, nuk do të nënshtrohet ndryshimeve dhe, është e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës.
- 3.3 Paga do të bëhet pas pranimit të paisjeve nga ana e Komisionit për Pranim të Mallit të Autoritetit Kontraktues.

Neni 4 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (c) Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);
- (d) Dhe dokumente tjera të cilat vlerësohen të nevojshme të jenë pjesë e kësaj kontrate.

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar

¹⁷ DDP – Dërgesat e Detyrës të Paguara –Incoterms 2010 Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.

dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj "ose"vendosë "do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe² në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.


Për Autoritetin Kontraktues:

Emri:	Saranda Cakaj
Pozita:	Drejtoreshë për Prokurim Publik
Nënshkrimi:	
Data:	07.08.2018
Vula:	



Për Kontraktuesin - Furnizuesin:

Emri:	Emin Mirena
Pozita:	Përfaqësues i : NTSH " Albkos Int " – Fushë Kosovë
Nënshkrimi:	
Data:	07.08.2018
Vula:	



² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

Shënim: Te përshkrimi i çmimeve duhet plotësuar vetëm kolonat F dhe G
 Në kolonën F ju duhet të plotësoni duke shkruar normën e TVSH-së, vetëm si numër 0, 8, apo 18, e jo në formatin 0%, 8% apo 18%, Ndërsa në kolonën G, duhet ta plotësoni me çmimin për njësi me TVSH, po ashtu çmimin duhet ta shkruani me dy decimale pas presëjes dhjetore

Nr.	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi për njësi pa TVSH	Norma e TVSH-së në %	Çmimi për njësi (me TVSH)-€	Totali (Pa TVSH)	TVSH	Totali (me TVSH)-€
1	GYP PROFESIONAL PËR SHUARJEN E ZJARRIT Ø 52 MM / 15M	copë	7	16.95	18.00	20.00	118.64	21.36	140.00
2	SHPINORE PËR SHUARJEN E ZJARREVE MALORE/FUSHORE	copë	4	55.08	18.00	65.00	220.34	39.66	260.00
3	ÇIZME PËR ZJARRFIKËS	palë	27	101.69	18.00	120.00	2,745.76	494.24	3,240.00
4	Drita ndriçuese për helmet me bateri rimbushëse 1.5 w	copë	30	10.17	18.00	12.00	305.08	54.92	360.00
TOTALI 1:							3,389.83	610.17	4,000.00

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI I OE:	ALBKOS INT., N.T.SH.
EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT OE:	EMIN MIRENA
NËNSHKRIMI:	
DATA:	7/9/2018
VULA:	